


TaxNews

SPECIAL

Dhjetor 2018
December 2018



Në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018 është publikuar pjesa e dytë e Paketës Fiskale 2019 (pjesën e parë të Paketës Fiskale 2019 e kemi përmbledhur në Special Tax News të muajit korrik 2018). Ndryshimet kryesore që sjell kjo pjesë e dytë e Paketës Fiskale 2019 i kemi përmbledhur në disa publikime të njëpasnjëshme për lehtësi leximi. Të gjitha këto ndryshime hyjnë në fuqi më 01.01.2019 (përveç rasteve ku specifikohet ndryshe).

Ligji "Për TVSH"

Ndryshimet në këtë ligj kanë si qëllim kryesor mbështetjen e prodhimit vendas kryesisht në sektorin bujqësor dhe në atë të përpunimit të mallrave jo shqiptare me destinacion eksportin (industria fason), ndryshime në trajtimin e reklamave në media, politika stimuluese me qëllim reduktimin e ndotjes së mjedisit, etj.

● Furnizimi i shërbimit të reklamave

Furnizimi i reklamave do të ketë trajtim të ndryshëm për TVSH në varësi të llojit të medias që e furnizon reklamën:

- a. Reklama të furnizuara nga media e shkruar do të mbeten furnizime të përjashtuara nga TVSH (*trajtimi i këtij furnizimi nuk ka pësuar ndryshime*);
- b. Reklama të furnizuara nga media audiovizive (televizionet) do të jenë të tatueshme me normë të reduktuar prej 6% (*më parë, ky furnizim ishte i përjashtuar nga TVSH*);
- c. Reklama të furnizuara nga media elektronike do të jenë të tatueshme me normën standarde 20% (*më parë, ky furnizim ishte i përjashtuar nga TVSH*).

The second part of the Fiscal Package 2019 has been published (please find the first part of the Fiscal Package 2019 summarized in our Special Tax News of July 2018). For easier reading, we have summarized the main changes brought by this second part of the Fiscal Package 2019 in a few consecutive articles. All these changes enter into force as of 01.01.2019 (unless otherwise stated).

Law "On VAT"

The main objective of the changes in this law is to support the domestic production mainly in the agricultural and inward processing sectors, bring changes to the treatment of advertising in media, establish incentivizing policies for the reduction of pollution, etc.

● Supply of advertising service

The supply of advertising services shall have different VAT treatment depending on the type of the supplying media:

- a. Advertising supplied by written media shall remain exempt from VAT (*there are no changes to its treatment*);
- b. Advertising supplied by audiovisual media (televisions) shall be taxable at the reduced rate of 6% (*previously, this service was exempt from VAT*);
- c. Advertising supplied by electronic media shall be taxable at the standard rate of 20% (*previously, this service was exempt from VAT*).

- **Furnizimi i librave**

Furnizimi i librave do të jetë i tatueshëm me normë të reduktuar prej 6% (*më parë, ky furnizim ishte i përjashtuar nga TVSH*).

- **Furnizimi i mjeteve të transportit publik të udhëtarëve**

Furnizimi i autobuzave me motor elektrik me 9+1 ose më shumë vende, si mjete të transportit publik të udhëtarëve, do të tatohet me normë të reduktuar të TVSH-së prej 6% deri më 31.12.2021 dhe me 10% nga 01.01.2022 e në vijim.

- **Furnizimi i makinave bujqësore dhe inputeve bujqësore**

Furnizimi i makinave bujqësore sipas një liste që pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave, do të jetë i përjashtuar nga TVSH si për furnizimet brenda vendit ashtu dhe në import (*më parë, ky përjashtim ishte i vlefshëm vetëm për importet*).

I përjashtuar do të jetë gjithashtu edhe furnizimi i inputeve bujqësore (plehrat kimikë, pesticidet, farat dhe fidanët) sipas një liste që do të përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë që zbatojnë regjimin e kompensimit të fermerëve do të jetë 6% (*më parë ishte 20%*).

- **Furnizimi i shërbimeve veterinare**

Furnizimi i shërbimeve veterinare do të jetë i përjashtuar nga TVSH. Megjithatë, shërbimet veterinare për kafshët shtëpiake do vijojnë të jenë të tatueshme me normën standarde 20%.

- **Supply of books**

Supply of book shall be taxable at the reduced rate of 6% (*previously, this supply was exempt from VAT*).

- **Supply of means for public transportation of passengers**

Supply of electric motor buses of 9+1 or more seats, as means of public transportation for passengers, shall be taxable at the reduced rate of 6% until 31.12.2021 and of 10% starting from 01.01.2022 and onwards.

- **Supply of agricultural machinery and inputs**

Supply of agricultural machinery based on a list expected to be approved by the Council of Ministers, shall be exempt from VAT for domestic supplies as well as for imports (*previously, such exemption was available only for imports*).

Supply of agricultural inputs shall also be exempt from VAT (chemical fertilizers, pesticides, seeds and saplings) according to a list to be determined by the Council of Ministers.

The rate of compensation of agricultural producers that apply the farmers' compensation regime shall be 6% (*previously, it was 20%*).

- **Supply of veterinary services**

Supply of veterinary services shall be exempt from VAT. However, veterinary services for pets shall continue to be at the standard rate of 20%.

- **Furnizimi i përpunimit të mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv**

Furnizimi i shërbimeve të përpunimit të mallrave nga nënkontraktorë për operatorët ekonomikë që veprojnë në sektorin e përpunimit aktiv (të ashtuquajtur industria "fason"), do të trajtohet si eksport me 0% TVSH (sikurse edhe vetë shërbimet e furnizuara nga këta operatorë ekonomikë).

Pritet që Ministri i Financave të miratojë me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e këtij trajtimi.

- **Importimi i lëndëve të para për prodhimin e barnave**

Importimi i lëndëve të para për prodhimin e barnave, me përjashtim të lëndëve me përdorim të dyfishtë, nga ana e mbajtësve të autorizimit për prodhimin e tyre do të jetë furnizim i përjashtuar nga TVSH.

Pritet që Këshilli i Ministrave të miratojë me vendim listën e lëndëve të para që përfitojnë nga përjashtimi.

- **Supply of processing of goods under the inward processing regime**

Supply of goods processing services by subcontractors of economic operators in the inward processing industry (the so-called "fason" industry), shall be treated as export with 0% VAT (same as the current treatment for the services provided by these economic operators).

The Minister of Finance is expected to approve through an instruction the necessary documentation for the application of this treatment.

- **Import of raw materials for drugs production**

Import of raw materials for the production of drugs, except those of dual usage, from the persons authorized for their production shall be exempt from VAT.

The Council of Ministers is expected to approve the list of raw materials that benefit from such exemption.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit
Gjeologji Miniera
Tirana | Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.